REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 731/20
Datë/Datum. 26.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***14.10.2020***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***26.10.2020***	***Nr. i lëndës:*** ***731/20***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.09.2020, OE "Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec, ka parashtruar ankesë me nr: **731/20,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE N.N.P "B-Engineering"- Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim me paisje industriale per kuzhine",*** me nr.të prokurimit:1020890500-20-4709-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Qendra e Studenteve .

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës furnizim, vlerë e madhe, vlera parashikuar e kontratës: 150 000 €.

Data e njoftimit për kontratë 01.09.2020, data e hapjes së ofertës 22.09.2020, kërkesa për rishqyrtim 16.09.2020, data e dhanjës se kontratës 28.09.2020

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë
Neni 6, 7, 19, 28, 44 dhe 108/A të **LPP-së**
Pika 20.8 legjislacionit sekondar A01 Rregullat dhe Udhezuesi Operativ për PP

DEKLARATA DETALE E ANKESES

1.Me datën 12 09 2020 kemi dorzuar prane AK kerkes per informata shtese (DOK1 total 3 faqe)
AK me daten 16.09.2020 na ka derguar pergjigje ne informatat shtese te kerkuara nga ana jone me daten (DOK 2 total 3 faqe) AK ne pergjigjen e dhene ne kerkesen tone lidhur me kriterin "PRODUKTET DUHET TE JENE NGA PRODHUESIT BE" se eshte kriter diskriminues, AK na eshte pergjigjen se ky kritere eshte vendosur me qellim qe te furnizohemi me paisje kualitative dhe kete kriter nuk e ka cilsuar si diskriminues.
Dhe kjo pergjigje eshte dhene ne nje dokument ne formate WORD i pa nenshkruar dhe i pa vulosur dhe as nuk permbane date apo ndonje shenjë tjetër të nje shkrese zyrtare.

Me daten 16.09.2020, pas marjes se pergjigjes nga AK mbi kerkesen per informata shtese, kemi prarashtruar KERKES PER RISHQYRTIM nepermjet e-prokurimit por edhe te njejten e kemi derguar nepermjet emailit duke e njoftuar me shkrim AK se kemi dorzuar kërkes për rishqyrtim, pasi qe afatet ishin të shkurta gjashtë (6) dite para afatit të fundit për dorzim te tenderit.

Me daten 17.09.2020 ju kemi drejtuar AK nepermjet emailit qe te na informojne se a e kane pranuar kerkesen per rishqyrtim, mirpo nuk kemi pranuar asnjë informate. Këtë email e kemi derguar duke parë se AK nuk ka mare asnje veprim te parapar me LPP ne momentin e pranimit te kerkeses per rishqyrtim. Pasi qe nuk kemi asnje vendim nga AK sa i perket kerkeses per rishqyrtim kemi kalkuluar edhe afatet ligjore per te drejten e paraqitjes se ankeses dhe ate si me poshte:
16.09.2020 eshte paraqiture kerkes per rishqyrtim.
21.09.2020 eshte afati prej 3 dite pune qe AK ta shqyrtoje kerkes per rishqyrtime.
Pasi datat 19 dhe 20 jane dite pushimi vikend)
Dhe nga data 21.09.2020 kemi afate prej 10 dite paraqitjen e ankeses prane OSHP.
Duke u mbeshtetur ne informata e lartecekura jemi te bndur se pikat ankimore jane te bazuar ne legjislacion dhe duhet mare masa ne menyre qe ky aktivitet i prokurimit te kthehet ne biare.
Dispozitat qe jane shkelur jane:
2.Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosëmarveshjeve
Paragrafi 2 Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

AK ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozit duke mos e pozulluar aktivitetin e
prokurimit deri ne marjen e vendimit.

Paragrafi 6 Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

AK nuk e ka shqyrtuar kerkesen tone brenda afatit prej 3 ditë pune nga data e dorzimit te kerkeses për rishqyrtim dhe nuk na ka dorzuar asnje vendim deri momentin e dorzimit te kesaj ankese pran OSHP.

3.Neni 6 LPP - Ekonomiciteti dhe efikasiteti

Paragrafi 1 Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike,njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Ne baze te kufizimeve qe jane vendosur ne specifikat te tenderit per artikujte me nr rendore 1,2,3,4 dhe 5 duke kufizuar origjinen "Produktet duhet te jene nga Prodhuesit BE si dhe Artikulli me nr 9 ku eshte specifikuar prodhuesi S&P AK nuk do ti perdore fondet publike ne menyre me ekonomike pasi qe ne tregë ka produkte me kualitet me te lartë që janë nga prodhues jashte BE-së nga produktet e prodhuara ne shtete e BE, sikurse qe ka produket me kualitet me te ulet edhe pse prodhohen ne njërin nga shtete antare te BE.

4.Neni 7 LPP - Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Paragrafi 1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

-AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime në origjine te produkteve vetem nga nje teritori per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne, bene shkelje te kesaj dispozite ku neve si kompani por edhe kompani tjera na dikriminon dhe na kufizon pjesmarje te kete tender.

Paragrafi 2 Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

-AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritori të caktuar per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne bene shkelje te kesaj dispozite ku neve si kompani na eliminon nga pjesmarje ne kete aktivitet te prokurimit.

5.Paragrafi 3 Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.
-AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritori të caktuar per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne bene shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjine ka favorizuar nje apo me shume kompani dhe na ka diskriminuar neve si kompani por edhe kompani tjera qe nuk mune te plotesojme kete kritere te specifikacioneve teknike.

6.Paragrafi 4 Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.
-AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritore të caktuar per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne bene shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjine na ka dikriminuar ne kufizim territorial.

7.Paragrafi 5 Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose siqurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik. Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit.

AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritore bene shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjine na detyrone qe te furnizojme produkte nga nje rajon i vecant gjeografik per produkte rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P – Spajne.

8.Paragrafi 6 Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; .... (vazhdon)

AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritore të caktuar per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne bene shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjine kufizone pjesemarrjen te OE te interesuar per pjesmarje ne ke aktivitet te prokurimit.

AK nuk ka siguruar eliminimin e kritereve dhe specifikemeve teknike duke na diskriminuar neve si kompani por ka favorizuar nje apo me shume OE.

9.NENI 28 i LPP Specifikimet teknike

Paragrafti 2 Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. **Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik**.

AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritore ka perpiluar specifikime teknike ka bere shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjinesë nje teritore të caktuar per artikujt me nr rend 1 deri 5 si dhe per artikullin nr 9 duke kufizuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne ka kufizuar pjesemarrjen te OE duke diskriminuar OE si dhe duke favorizuar disa OE.

Paraqrafi 7 Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm. ose ndonjë shenie dalluese, lloii ose oriqjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që në kushte të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontratës përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. Të këtij neni ose ndryshe; me kusht që, çfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët "ose ekuivalent".

AK ka perpiliar specifikacone teknike ku i eshte referuar burimi te vecante per artikullin nr 9 duke e saktesuar prodhuesin (marken) S&P - Spajne si dhe i eshte referuar origjines te vecante per artikujte 1 deri 5 duke specifikuar nje origjine te vecante "Produktet duhet te jene nga Prodhuesit BE"

10. A01_Rregullat dhe Udhezuesi Operativ per Prokurimin Publik Legjislacioni sekondar
20.8 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente".

AK me kufizime te vene ne specifikat teknike duke percaktuar kufizime ne origjine te produkteve vetem nga nje teritore bene shkelje te kesaj dispozite ku me vendosjen e kufizimeve te origjine per artikujt 1 deri 5 si dhe per artikullin 9 duke percaktuar prodhuesi (marken) S&P (prodhues spanjolle).

11. NENI 19 I LPP - Klasifikimi i Kontratës Publike sipas Vlerës së Parashikuar
-Paragrafi 1 Kontrata me vlerë te madhe" konsiderohet me sa vijone 1.1 kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritet që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro
Sipas vlerës së parashikuar te kontratë e cila nga 100.000,00 Euro qe eshte ne verzion fillestare te publikuar me daten 26.08.2020 e korigjuar pastaj me daten 01.09.2020 ne vlere te parashikuar ne 150.000,00 Euro.

Me ngritjen e vleres se parashkiuar eshte shkelur paragrafi 1.1 i Nenit 19 i LPP ku pas ndryshimit te vleres se parashkuar ndryshone klasifikimi i kontratave publike dhe si rrjedhoje ndryshojne afatet kohere per dorzim te tenderit.

12. NENI 44 i LPP - Rregullat e Pergjithme per caktim e afateve kohore per pranimin
e Tendereve ose Kerkesave per pjesemarrje
-Paragrafi 2.1 Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është: kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë;
AK pas ndryshimit të vleres se parashikuar nga 100.000,00 Euro ne 150.000,00 Euro është dashte qe

vazhdoje afatin për dorzimin e tenderit në min 40 ditë nga data e publikimit te ndryshimit duke patur parasyshe se ne Njoftimin për Kontrate nuk është cekur se ky aktivitet eshte me afate të shkurtuar.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **Operatori Ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka realizuar projekte te ngjashme ne tre vitet e fundit deri ne daten e ketij njoftimi, ku përfshihen titujt e projekteve, vlera, numri, data e kontraktimit dhe dëshmi për përfundimin me suksese te këtyre projekteve.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **Te dorëzoni listën në origjinal e vulosur dhe nënshkruar, të projekteve të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit deri ne daten e ketij njoftimi dhe dëshmitë e përfundimit Referencat ose procesverbalet e pranimit te puneve.**
		Personeli i operatorit ekonomik, listen e punetoreve qe jane te perfshire drejperdrejt ne realizimin e ketyre furnizimeve.	**Operatori ekonomik duhet te deshmoje se ka te angazhuar (ose do t'i angazhoj) staf profesional per montimin dhe servisimin e ketyre paisjeve.**
		OE duhet te ofroje garancion 24 mujor per paisjet e ofruara.	**deklarate e nenshkruar dhe e vulosur mbi garancionin e paisjeve per furnizim.**
		OE duhet te ofroje autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar.	**Autorizimi i prodhuesit ose autorizimi i dilerit nga prodhuesi per keto paisje.**
		OE duhet te ofroje nje katalog per keto paisje.	**Katalogu duhet te permbaje pershkrime teknike per pozicionet nga 1 deri 13.**
		OE duhet te ofroje certifikate CE per paisjet e ofruara.	**Certifikate e prodhuesit ose e distributorit sipas standardeve CE.**
		OE duhet te ofroje deklarat per trajnimin e stafit te Autoritetit Kontraktues per perdorimin e ketyre paisjeve.	**Deklarate origjinale mbi trajnimin e stafit tone e nenshkruar dhe e vulosur.**

4. RAPORTI I KOMISIONIT RI VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit, komisioni vlerësues me dt 28.09.2020, ka konstatuar si në vijim: AK-Qendra e Studenteve shpërblen me kontratë OE N.N.P "B-Engineering"- Suharekë në vlerë totale prej 134,254.00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Qendra e Studenteve, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të madhe. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër specifikave teknike për disa pozicione dhe disa shkeljeve procedurale.

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec

Lidhur me pretendimin e OE ankues se me datë 12.09.2020 ka parashtruar kërkesë për informata shtesë pranë AK, ku me datë 16.09.2020 AK i kthen përgjigje lidhur me kriterin "PRODUKTET DUHET TE JENE NGA PRODHUESIT BE" duke sqaruar se ky kriter është vendosur me qëllim që të furnizohet AK me pajisje kualitative dhe këtë kriter nuk e ka cilësuar si diskriminues. Më tej, OE ankues potencon se përgjigja e AK-së është dhënë në një dokument në formatin "word" i pa nënshkruar dhe i pa vulosur, si dhe nuk përmban datë apo ndonjë shenjë tjetër të një shkrese zyrtare.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në FDT dhe në njoftimin për kontratë ka kërkuar:

OE duhet te ofroje certifikate CE per paisjet e ofruara.	Certifikate e prodhuesit ose e distributorit sipas standardeve CE.

Kurse, në pozicionet nga 1 deri në pozicionin 5 të para masës dhe para llogarisë, AK ka kërkuar:

PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE PASJET PËR KUZHINË							
A	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi/ Njësi pa TVSH	TVSH për njësi	Çmimi për njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH
1	Furre me avull kapaciteti I tepsiave 20*GN 2/1cm, me karroce, komanda digjitale, larje automatike, pjekje adabtive, temp: 30 °C – 300 °C, deri në 10 kohëmatës për shumë produkte gatim në të njëjtën kohë, deri 384 programe te ruhen te shkruara me foto, 65kW, 380-415 V 3PH+N+PE, Dim:892x1257x1875 (mm), 339kg PLUS Electric, lartesia ndermjet tepsiave 67mm, ventilatorin ne menyre automatike ndalet me hapjen e derës, paneli kontrollues kapacitiv i ekranit me prekje 9.5" **Vërejtje: Produktet duhet të jenë nga (Prodhuesit e BE)**	Copë	2.00				
2	Kiper me rryme, tave elelktrike inox 304, kazani me mekanizem te pjerrtesi te motorizuar (inox) kap:120Litra, fundi I enes 12mm, FE430 & AISI 316, me kapak inox 304, mbushje te ujit automatike, 100° deri 280 C°, 13.50KW, Dim.1200-900-870h, dhe dim: e enes 1170x710x200h. VAC400-3N 50/60 Hz, rezistete ndaj ujit - IPX5, CE, ISO 9001 & 14001 **Vërejtje: Produktet duhet të jenë nga (Prodhuesit e BE)**	Copë	2.00				
3	Kiper me plin, tave plini inox 304, kazani me mekanizem me pjerrtesi te motorizuar (inox) kap:120Litra, fundi I enes 10mm, me kapak inox 304, mbushje te ujit automatike, 100° to 280 C°, 24KW, ndezja operohet nga piloti elektirik me valvul gazi. Dim.1200-900-870h, dhe dim: e enes 1170x710x200h, rezistete ndaj ujit - IPX5, CE, ISO 9001 & 14001 **Vërejtje: Produktet duhet të jenë nga (Prodhuesit e BE)**	Copë	2.00				
4	Kazan me zierje indirekte me avull me kapak autoklave me presion 0.45 bar, inox 304, kazani inox 304/316 me fund te trashë, valvula e sigurisë së xhaketës me manometër dim:1300x1140x1070mm, dim: I kazanit 900x780mm, kap:480litra **Vërejtje: Produktet duhet të jenë nga (Prodhuesit e BE)**	Copë	2.00				
	Fritez 2 x 22lit, me dy shporta, me kapak, 80x90x87cm/h, 36kw, elektrike, inox 304, 20/10 inox i trashë, pus me zonë të gjerë të						

Table 1

Pra, eksperti shqyrtues për këtë pretendim sqaron se në nenin 20.4 të RRUOPP-së është përcaktuar që specifikimet /TER do të jenë të qarta, të sakta dhe precize dhe duhet të mos paraqesin kufizime të panevojshme, në mënyrë që të mos kufizohet konkurrenca. Ato duhet të përkufizohen në mënyrë që mos të krijojnë dyshime rreth natyrës së mallrave, punëve ose shërbimeve të kërkuara. Pra, kërkesa e AK-së që operatorët ekonomik duhet të ofrojnë certifikatë "CE" është kërkesë konform nenin 20.5 dhe 20.6 të RRUOPP-së sepse në pikën 2 tek "Hierarkia e Standardeve që do të referohet gjatë formulimit të specifikimeve teknike" është lejuar që të kërkohet një standard evropian. Mirëpo, ky kriter i përcaktuar në FDT dhe njoftimit për kontratë është në kundërshtim me para masën dhe para llogarinë sepse në para masë nuk kërkohet standardi "CE" por decidivisht është përcaktuar "vërejtje: produktet duhet të jenë nga prodhuesit e BE-së". Pra, kërkesa në para masë "produktet duhet të jenë nga prodhuesit e BE-së" është në kundërshtim me FDT dhe njoftimit për kontratë, si dhe në kundërshtim me nenin 20.8 të RRUOPP-së, ku thuhet:

- 20.8 Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origjina specifike ose prodhime, është si rregull i përgjithshëm **i ndaluar**. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët **"ose e barasvlershme/ekuivalente"**

Andaj, eksperti shqyrtues konsideron se ky pretendim ankimor është i bazuar sepse autoritetet kontraktuese nuk duhet që të kërkojnë produkte apo furnizimeve nga prodhues të caktuar por ju lejohet që të kërkojnë standarde të caktuara ashtu siç është përcaktuar në nenin 20.5 dhe 20.6 të RRUOPP-së.

Sa i përket pretendimit të OE ankues, se me datë 16.09.2020 parashtron kërkesë për rishqyrtim përmes e-prokurimit dhe përmes emailit duke e njoftuar AK me shkrim se ka dorëzuar kërkesë për rishqyrtim, pasi që afati ishte i shkurtër, gjashtë (6) ditë para afatit të fundit për dorëzim të tenderit. Pasi që AK nuk i kishte kthyer përgjigje kërkesës për rishqyrtim të OE ankues, me datë 17.09.2020 i është drejtuar AK-së përmes emailit që të informojnë nëse e kanë pranuar kërkesën për rishqyrtim. Mirëpo, OE ankues pretendon se nuk ka pranuar asnjë informatë. Më tej, OE ankues në këtë ankesë pretendon se AK ka shkelur nenin 108/A për shkak se nuk ishte përgjigjur në kërkesën për rishqyrtim. Po ashtu, AK nuk ka pezulluar aktivitetin e prokurimit siç është paraparë në LPP.

Eksperti shqyrtues sqaron se OE ankues ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim me datë 16.09.2020, kurse AK me datë 18.09.2020 kthen një përgjigje, ku thuhet:

Pergjigje – AK Qendra e Studenteve

Sipas ligjit te Prokurimit publik, perkatesishte neni 70 thote:

"Autoriteti kontraktues do t'i pranojë certifikatat e barasvlershme të lëshuara nga cilido organ certifikues pavarësisht nga vendi, nëse organi i tillë pranohet nga një shtet anëtar i BE-së."

Pra, duke pasur parasysh kërkesën për rishqyrtim të OE ankues me rreth dhjetë (10) pretendime dhe përgjigjen e AK-së, si dhe mos pezullimin e aktivitetit të prokurimit, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 108/A sepse nuk e ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim dhe nuk e ka bërë pezullimin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç është përcaktuar në nenin 108/A. Sepse me rastin e parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, AK është dashur që automatikisht të bëjë pezullimin e aktivitetit të prokurimit dhe konform par. 10 të nenit 108/A autoriteti kontraktues me anë të një **vendimi** mundet të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë apo të miratojë një

kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar, kurse paragrafi 11 i nenit 108/A përcakton se **vendimet e parashikuara janë të detyrueshme** për autoritetet kontraktuese dhe duhet të zbatohen menjëherë. Pra, për mendimin e ekspertit shqyrtues ky pretendim ankimor është i bazuar.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, se AK nuk ka pasur parasysh nenin 6 të LPP-së për shkak të kufizimeve që janë vendosur në specifikimet teknike për artikujt me numër rendor 1,2,3,4 dhe 5, duke kufizuar origjinën "Produktet duhet të jenë nga prodhuesit e BE-së, si dhe Artikulli me nr. 9, ku është specifikuar prodhuesi S&P".

Eksperti shqyrtues për këtë pretendim sqaron se specifikimi i AK-së në para masë që produktet duhet të jenë nga prodhuesit e BE-së mund të ndikoj në ekonomicitetin dhe efikasitetin për shkak se prodhimet në një regjion të caktuar mund të ngritin çmimet. Kurse, në rastin kur autoritetet kontraktuese kërkojnë cilësi për produkte të caktuara munden që të kërkojnë standardin e caktuar sepse shumë produkte prodhohen në vende ku kostoja e ekonomisë së prodhimit është më e ulët por pa ndikuar në cilësinë apo kualitetin e produktit.

Lidhur me pretendimin e OE ankues, se AK nuk ka respektuar nenin 7 dhe 28 të LPP-së, si dhe nenin 20.8 të RRUOPP-së për shkak të kufizimeve në specifikimet teknike dhe kërkesës që produktet të prodhohen në BE, konkretisht duke kufizuar prodhuesin (markën) S&P – Spanjë.

Eksperti shqyrtues sqaron se përkufizimi i AK-së në para masë është dy kuptimesh për shkak se në pozicionin 9 tek para masë thuhet "pa prodhues S&P". Pra, AK nuk ka sqaruar nëse e ka eliminuar prodhuesin "S&P" apo ka kërkuar produkte "S&P". Megjithatë, në cilindo version nuk lejohet që të favorizohet apo diskriminohet ndonjë prodhues apo operator ekonomik sepse është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

OE ankues pretendon se AK ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 19 dhe 44 të LPP-së me rastin e klasifikimit të kontratës publike sepse me ngritjen e vlerës së parashikuar të kontratës është shkelur paragrafi 1.1 i nenit 19 të LPP-së, ku pas ndryshimit të vlerës së parashikuar ndryshon klasifikimi i kontratave publike dhe si rrjedhojë ndryshojnë afatet kohore për dorëzim të tenderit.

Eksperti shqyrtues sqaron se në neni 19 të LPP-së është përcaktuar:

1. "Kontratë me vlerë të madhe" konsiderohet me sa vijon:

1.1. kontrata e furnizimit ose kontrata e shërbimeve, vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë ose më e madhe ose mund të pritet që të jetë e barabartë ose më e madhe se njëqind njëzet e pesë mijë (125.000) Euro;

Kurse, në nenin 44 të LPP-së është përcaktuar:

2. Gjatë një prokurimi që zbaton procedurën e hapur, autoriteti kontraktues do të caktojë një afat kohor për pranimin e tenderëve që është:

2.1 kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, jo më pak se dyzet (40) ditë;

Andaj, duke pasur parasysh që njoftimi për kontratë është me datë **25.08.2020** dhe afati i fundit për dorëzimin e tenderit është me datë **22.09.2020**, eksperti shqyrtues sqaron se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 19 dhe 44 të LPP-së, dhe se pretendimi ankimor është i qëndrueshëm.

Përfundimisht, bazuar në atë që u përshkrua më lartë, eksperti shqyrtues rekomandon që ky aktivitet i prokurimit të anulohet në tërësi pasi që OE-të pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit nuk janë trajtuar në mënyrë të drejt sipas parimeve të prokurimit publik. Rrjedhimisht, përveç mos respektimit të procedurës nuk janë respektuar në tërësi edhe dispozitat e LPP-së, përkatësisht nuk është respektuar nenit 7, 28, 19, 44, 59 dhe 108/A i LPP-së, si dhe dispozitat e RRUOPP-së siç janë cekur më lartë.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e dhëna në këte raport propozimi ynë është qe ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar.Te anulohet ne tërësi aktiviteti i prokurimit dhe nëse AK, ende ka interes te njëjtin ta **RI TENDEROJ**.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Qendra e Studenteve
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "Osa Termosistem"sh.p.k -Rahovec